

**V E N D I M**  
**Nr.345, datë 12.6.1993**

**PËR RRIJTJEN E PENSIONEVE, TË PËRKRAHJES SOCIALE DHE TË NDIHMAVE  
EKONOMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, si dhe të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**1. Për pensionet:**

Të rriten pensionet dhe ndihmat që përfitohen nga ligji nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", në masën 15 për qind.

2. Kufijtë e masës së pensioneve, të ndihmave dhe të pagave kufi, të parashikuara në ligjin nr.4171, datë 13.9.1966 "Për sigurimet shoqërore", ndryshohen si vijon:

- Në nenin 17, paragrafi i fundit, masa e pensionit bëhet 1237 lekë në muaj.
- Në nenin 17/a, paragrafi i dytë, pensioni për vjetërsi shërbimi për raste të veçanta nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe më i lartë se 1685 lekë në muaj.
- Në nenin 17/b paragrafi i fundit, pensioni i parakohshëm nuk mund të jetë më i lartë se 1967 lekë në muaj.
- Në nenin 19/a, masa e ndihmës bëhet 564 lekë në muaj.
- Në nenin 20, paragrafi i dytë, pensioni i pleqërisë nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1967 lekë në muaj.
- Në nenin 20/a, paragrafi i tretë, kufiri i pagës bëhet 2525 lekë në muaj.
- Në nenin 24, paragrafi i tretë, pensioni i invaliditetit nuk mund të jetë më i ulët se 1576 lekë për grupin e parë, 1392 lekë për grupin e dytë, 1283 lekë për grupin e tretë dhe 558 lekë për grupin e katërt dhe as më i lartë se 2042 lekë për grupin e parë dhe të dytë, 1748 lekë për grupin e tretë dhe 1024 lekë në muaj për grupin e katërt.
- Në nenin 25, paragrafi i parë, personat që përmenden në shkronjat "c" "ç" dhe "d" të nenit 21 të ligjit, kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe bëhen invalidë, marrin pension invaliditeti mujor në këto masa:

Grupi I.....1317 lekë

Grupi II.....1024 lekë

Grupi III..... 864 lekë

Grupi IV..... 368 lekë

- Në nenin 31, paragrafi i dytë, pensioni familjar nuk mund të jetë më i ulët si 1340 lekë për familje me tre ose më shumë anëtarë, 989 lekë për familje me dy anëtarë dhe 777 lekë në muaj për familje me një anëtar dhe as më i lartë se 1967 lekë për familje me tre ose më shumë anëtarë, 1403 lekë për familje me dy anëtarë dhe 961 lekë në muaj për familje me një anëtar.

- Në nenin 32, paragrafi i parë, anëtarët e familjes të personave që përmenden në shkronjat "c", "ç" dhe "d" të nenit 21 të ligjit, kur nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe mbajtësi i familjes vdes, marrin pension familjar mujor në masën që vijon:

Për familje me 3 ose më shumë anëtarë.....1122 lekë

Për familje me dy anëtarë..... 915 lekë

Për familje me një anëtar..... 633 lekë

Në nenin 40, paragrafi i dytë, paga kufi bëhet 2525 lekë në muaj. Sipas paragrafit të fundit të këtij neni, pensioni për vjetërsi shërbimi 25 vjet e lart për burrin dhe 20 vjet e lart për gruan nuk mund të jetë më i ulët se 1237 lekë në muaj dhe as më i lartë se 1685 lekë në muaj.

- Në nenin 45, paragrafi i parë, masa e pensionit bëhet 1967 lekë në muaj.

3. Për rritjen e përkrahjes sociale për personat që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike:

a) Personave që trajtohen me përkrahje sociale gjer më 30.6.1993, u rritet pagesa për përkrahje sociale në masën 10 për qind mbi atë ekzistuese.

b) Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.409, datë 12.11.1991 "Për përkrahjen sociale të personave që dalin të papunë nga zbatimi i reformës ekonomike", në pikën 8 paga minimale mujore bëhet 1090 lekë.

4. Në vendimin nr.59, datë 18.3.1983 "Për trajtimin e të huajve që strehoen në Republikën e Shqipërisë", në pikën 3, në paragrafet 1 dhe 2 masa e ndihmës së përhershme mujore bëhet 1140 lekë dhe në paragrafin 5 masa e ndihmës bëhet 1520 lekë.

5. Qendrat e pagesës së pensioneve të llogaritin rritjen e pensioneve (pa përfshirë kompensimin e veshmbathjes, shpërblimin mbi pension për Luftën Nacionalçlirimtare dhe kompensimin për frymë nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë) në masën e parashikuar në këtë vendim dhe të kryejnë pagesat.

6. Efektet financiare që lindin nga zbatimi i këtij vendimi, mbulohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 1993. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të bëjë detajimin e këtyre efekteve sipas ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet ekonomike shtrihen nga data 1 gusht 1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
**Aleksandër Meksi**